

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 4

“Mbi korigjimin e vendimi nr. 96 datë 09.01.2019”

Sot në datë 12.02.2019, trupi gjykues, ora 16:00 i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Relatore</b>

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Etleda Çiftja, për korigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Gentian Jahjollli:

Në vendimin nr. 96 datë 09.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në seksionin IV “PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS”, pika nr. 27, togfjalëshi “Si konkluzion për kontrollin e figurës nuk rezultoi se” të korigjohet me togfjalëshi “Si konkluzion për kontrollin e figurës rezultoi se”.

Trupa pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi), në faqen e parë të vendimit.

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 96 datë 09.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në seksionin IV “PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS”, pika nr. 27, togfjalëshi “Si konkluzion për kontrollin e figurës nuk rezultoi se” të korigjohet me togfjalëshi “Si konkluzion për kontrollin e figurës rezultoi se”. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.

2. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Firdes Shuli**

**Pamela Qirko**


**Etleda Çiftja**

**Trupi Gjyqësor**

**Kryesues**

**Anëtar**

**Relator**



Sekretare gjyqësore  
Anisa Duka





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 139 Akti

Nr 96 Vendimi  
Tiranë, më 09.01.2019

**V E N D I M**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. John Leonardo, më datë 8 janar 2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Gentian Jahjoli, këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,  
**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z.

Gentian Jahjoli, vëzhguesin ndërkombëtar, z. John Leonardo, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Gentian Jahjoli, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 07.07.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" dhe ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim si ligji nr. 84/2016), specifikon se: *"Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio"*.

2. Në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", z. Gentian Jahjoli, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar, më datë 15 maj 2018, me trupin gjykues të përbërë nga:

Firdes Shuli Komisionere

Pamela Qirko Komisionere

Etleda Çiftja Komisionere

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim si "**ILDKPKI**"), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim si "**DSIK**"), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim si "**IKLD**"), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar, më datë 15.05.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim si "**Komisioni**"), me vendimin nr. 1, datë 25.05.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit, komisionere Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Më datë 24.12.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, bazuar në raportin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Më datë 24.12.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me e-mail; (iii) njohjen me provat e administruara nga

Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

7. Më datë 31.12.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoj shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve përfundimtare, duke qenë se nuk i ishte bërë e mundur aksesi në dokumentacion ditën që subjekti kishte ardhur për të askesuar dokumentacionin. Komisioni i dha dhe 3 ditë shtesë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

8. Më datë 07.01.2019, subjekti i rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit shpjegimet e tij së bashku me provat.

9. Më datë 03.01.2019, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 08.01.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

10. Më datë 08.01.2019, ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

11. Bazuar në piken 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të perfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Më datë 08.01.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht.

13. Seanca dëgjimore e datës 08.01.2019 u ndërpre, për të rifilluar, më datë 09.01.2019, për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoj konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

14. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

15. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë":

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit duke paraqitur pranë Komisionit një raport me

- konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
16. Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## V. RIVLERËSIMI I PASURISË

### V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.02.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, i cili është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2012, me numër indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

18. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2012 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar, më datë 25.01.2017, “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI-së nga viti 2012

<sup>1</sup> Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/1, pikë 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni. Kështu sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016, “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 3/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

deri 2016; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, më datë 07.01.2019, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**20.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshetjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

**21. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:**

**1. Llogari bankare rrjedhëse krijuar nga pagat.**

**a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:**

1.1 Deklaratën “Vetting” të viti 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

1.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë.

1.3 Vërtetimet e pagave nga institucionet ku ka punuar subjekti i rivlerësimit.<sup>2</sup>

**b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

1.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari rrjedhëse në vlerën 461.448,23 lekë. Zotërimi: 100 %.

1.5 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar pagat nga puna e kryer pranë: (i) Avokaturës së Shtetit (periudha 2009-2011), në shumën 1 693 844 lekë; (ii) Ministrisë së Drejtësisë (periudha 2011-2012), në shumën 689.717 lekë; (iii) Ministrisë së Brendshme (periudha 2012-2014), në shumën 1.423.904 lekë; dhe (iv) Gjykatës së Lartë (2014 - aktualisht), në shumën prej 2.915.468 lekësh, të derdhura pranë “Raiffeisen Bank”.

1.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se, nga institucionet bankare, “Raiffeisen Bank”<sup>3</sup> ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie në vlerën 461.448,23 lekë, më datë 31.12.2016, me përshkrimin - të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Avokaturën e Shtetit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe Gjykatën e Lartë.

1.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

1.8 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën dhe burimin e krijimit në përputhje me të dhënat e “Raiffeisen Bank”.

<sup>2</sup> Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së :

Nxjorje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 18.01.2017, në emër të z. Gentian Jahjollit mbi kreditimin o pagave. Gjodju në llogari, më datë 30.12.2016, në vlerën 461.448,23 lekë; Vërtetim page nr. 1202/1 prot., datë 3.11.2016, i lëshuar nga Avokatura e Shtetit, për të ardhurat nga paga dhe shpërblimet për z. Gentian Jahjollin, për periudhën 2009 - 2011. Shuma 1.702.844 lekë; Vërtetim page nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për z. Gentian Jahjollin për periudhën 2011- 2012. Shuma 698.717 lekë; Vërtetim page nr.7012 prot, datë 20.10.2016, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për të ardhurat nga pagat për z. Gentian Jahjollin, për periudhën 2012 - 2014. Shuma 1.423 . 904 lekë.

2Kërkesë drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë , nr. \*\*\* , datë 26.06.2018.

3 Përgjigje nga “Raiffeisen Bank”, nr. \*\*\* , datë 29.06.2018.

1.9 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie.

**2. Bashkëbanoj pa kundërshpërblim me prindërit në apartament banimi, me sip. 51m<sup>2</sup> + 28.6 m<sup>2</sup> shtesë anësore dhe shtesë e katit sipër apartamentit me sip. 84.1 m<sup>2</sup>, në Tiranë**

**a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:**

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.<sup>4</sup>

2.2 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë.<sup>5</sup>

2.3 Dokumentacionin e administruar nga ALUIZNI Tiranë.<sup>6</sup>

**b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

2.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëbanon pa kundërshpërblim me prindërit e tij në apartamentin e banimit në pronësi të prindërve në pasurinë. Apartament banimi, me sip. 51m<sup>2</sup>, krijuar nga privatizimi në vitin 1991 me nr. pasurie \*\*\*, ZK \*\*\*, shtesë anësore e apartamentit të banimit me legalizim, me sip. 28.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie 8\*\*\*, ZK \*\*\*, dhe shtesë e katit sipër apartamentit, me sip. 84.1 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, ZK \*\*\*, ndërtuar që në vitin 1998, ndodhur në, Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, Njësia Administrative Nr. \*\*\*. Sipërfaqja 51+28,6+84,1 m<sup>2</sup>.

2.5 Si burim i të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës anësore dhe katit mbi apartamentin, subjekti deklaron të ardhurat e personit të lidhur babait nga puna si taksist i licencuar.

2.6 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëbanon me prindërit dhe se deri në vitin 2016 kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare, referuar nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, babai dhe nëna e subjektit, Sh. dhe D. J janë objekt i hetimit administrativ për efekt të ligjit nr. 84/2016

2.7 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se apartamenti i banimit, me sip. 51m<sup>2</sup>, është përfituar nga prindërit e subjektit me kontratën për privatizimin e banesës, më datë 21.09.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komonale Banesa dhe qiramarrësit Sh. J, me vlerë të caktuar 2.550 lekë.

2.8 Kontrata e shitblerjes është lidhur mes Ndërmarrjes së Shërbimeve Komonale Banesa Tiranë dhe blerësve Sh. dhe D. J, në vlerën e likuiduar 2.040 lekë.

2.9 Më pas është ndërtuar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit shtesë anësore e apartamentit të banimit dhe shtesë e katit sipër apartamentit. Babai i subjektit të rivlerësimit, Sh. F. J është pajisur me leje legalizimi nr. 7993, datë 01.11.2011, për objektin shtesë anësore 3 kate + shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 2-katesh, në Njësine Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë, me këto të dhëna:

- Zona kadastrale, nr. 8310, nr. 8/157+1-7; 8/473+1-1 pasurie, -2.

<sup>4</sup> Kontratë për privatizimin e banesës, datë 20.09.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komonale Banesa dhe qiramarrësit Sh. J. Shuma për tu paguar 2.550 lekë.

- Kontratë shitblerje lidhur mes Ndërmarrjes së Shërbimit Komonale Banesa Tiranë dhe blerësve Sh. dhe D. J. Shuma e likuiduar në vlerën 2.040 lekë.

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 19.12.2005, për apartament me sip. 51m<sup>2</sup>, në pronësi të Sh. dhe D. J.

- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 09.05.2016, për apartament, me sip. 28.6 m<sup>2</sup> në pronësi të Sh. J. Shoqëruar me: kartelë pasuric, harta treguese e regjistrimit

- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 26.05.2016, për apartament, me sip. 84.1 m<sup>2</sup>, në pronësi të Sh. J. Shoqëruar me: kartelë pasuric, harta treguese e regjistrimit.

Votëdeklarim për legalizimin e shtesës papafingo, datë 22.06.2006, me sip. 27 m<sup>2</sup>, kryer nga Sh. J.

- Leje legalizimi, nr. \*\*\*, datë 01.11.2011, për shtesë anësore 3-kateshe + shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 2-katesh, me sipërfaqe totale të ndërtimit 119.9 m<sup>2</sup>, në emër të Sh. J.

<sup>5</sup> Përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 28.09.2018, e ZVRPP-së Tiranë.

<sup>6</sup> Përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 06.07.2018, e ALUIZNI-t.



- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore 26.3 m<sup>2</sup>.
- Sipërfaqja e ndërtimit 28.6 m<sup>2</sup>.
- Sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 119.9 m<sup>2</sup>.
- Numri i kateve mbi tokë 3.

2.10 Titulli i pronësisë mbi tokën i vërtetuar me dokumentin: Kontratë kalimi pronësie të parcelës ndërtimore, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.06.2011, në bazë të VKM-së, nr. 646, datë 28.07.2010, *“Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”*, i ndryshuar. Shtesë anësore në pll. \*\*\*, Rr. \*\*\*\*”.

2.11 ZVRPP-ja Tiranë<sup>7</sup> konfirmon se në emër të z. Sh. F. J dhe znj. D. M. J, figurojnë këto pasuri:

Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë, “Apartament”, me sip. 78.60 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. Sh. F. J (babai i subjektit);

- Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë, “Apartament”, me sip. 84,10 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. Sh. F. J;

- Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë, “Apartament”, me sipërfaqe 51.00 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. Sh. F. J dhe znj. D. M. J.

2.12 Komisioni hetoi në lidhje me vlerën e investuar nga babi i subjektit për shtesën anësore dhe shtesën e katit sipër apartamentit dhe subjekti i rivlerësimit deklaroi se, shtesa anësore dhe shtesa e katit sipër apartamentit është përfunduar së kryeri në vitin 1998, para 20 viteve, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka qenë me vendqëndrim në Itali, duke kryer studimet universitare në atë shtet. Pra, subjekti as ka qenë i pranishëm dhe as nuk ka pasur të ardhura në këtë kohë.

2.13 Më tej subjekti deklaroi se vlera e shtesës anësore ishte 360.000 lekë, ndërsa vlera e shtesës së katit ishte rreth 300.000 lekë. Kjo vlerë është përballuar në mënyrë jo të menjëhershme, por në mënyrë graduale në kohë. Shtesa e katit, edhe pse është mbyllur si ndërtim, është ende e pabanueshme, e pasuatuar, pa instalime sanitare dhe dyer dritare.

2.14 Vlera e shtesës është bërë me të ardhura të ndryshme, si për shembull nga puna si taksist, kamionist, shofer autobuzi dhe të ardhurat e shitjes së një kamioni 9 tonësh, të privatizuar nga Ndërmarrja e Ndërtimeve Ushtarake. Kontrata e privatizimit ishte lidhur me Bashkinë e Tiranës, si dhe të ardhurat e përfituara nga depozitat e kursimeve nga firmat piramidale (“Vefa” dhe “Sudja”).

2.15 Në përfundim të hetimit administrativ kryesisht, Komisionin, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar deklaratimet e tij gjatë hetimit në lidhje me vlerën e investuar në shumën prej 360.000 lekësh dhe 300.000 lekë dhe për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit ju kalua barra e provë s në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

2.16 Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait, paraqiti dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e z. Sh. J, a kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të investuar shumën prej 660.000 lekësh për shtesën anësore dhe katin mbi apartamentin<sup>8</sup>, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>7</sup> Përgjigje nr. \*\*\*, datë 28.09.2018, e ZVRPP Tiranë.

<sup>8</sup> 1. Deklaratë e ushtrimit të profesionit, datë 06.05.1996, nga z. Sh. J, 1 fq; 2. Mandatarkëtim, pagim tatimi nr. \*\*\*, datë 12.04.1996, nga z. Sh. J, 1 fq; 3. Mandatarkëtim, pagim tatimi, nr. \*\*\*, datë 12.04.1996, nga z. Sh. J, 1 fq; 4. Kontratë huadhënie, datë 06.11.1995, midis huadhënësit Sh. dhe D. J me shoqërinë “Vefa”, 1 fq; 5. Tërheqje interesi nga shoqëria “Vefa”, më datë 06.11.1996, nga z. Sh. J; 6. Tërheqje interesi nga shoqëria “Vefa”, më datë 06.09.1996, nga z. Sh. J; 7. Pasaporta e z. Sh. J dhe viza e ambasadës për angazhimin në udhëtimin në Spanjë, 8. Tërheqje depozitë nga shoqëria “Vefa”, më datë 15.05.1997, nga z. Sh. J, 9. Librocëft kushtimi pranë “NBG”-së në shumën 1.300 USD hapur, më datë 13.07.1997, në emër të z. Sh. J; 10. Mandatarkëtim, pranë “NBG”-së në shumën 1.900 DM hapur, më datë 13.06.1997, në emër të z. Sh. J; 11. Mandatarkëtim, pagim tatimi për vitin 2000, nr. \*\*\*, 1 fq. + mandatarkëtim, pagim tatimi, nr. \*\*\*, 1 fq, + mandatarkëtim, pagim tatimi, nr. \*\*\*, 1 fq, + mandatarkëtim, pagim tatimi, nr. 012006, 1 fq, nga z. Sh. J; 12. Leje veprimtarie për transport udhëtimi tregtarësh me taksì, nr. \*\*\* datë 14.11.2001, Dashkia Tiranë, me targa \*\*\*, në emër të z. Sh. J, 1 fq; 13. Vërtetim Dashkia Tiranë, më datë taksinë me targa 15.07.2003, \*\*\*, 1 fq, + mandatarkëtim datë 07.01.2004, + mandatarkëtim, datë 10.04.2003, +Mandatarkëtim, datë 02.06.2003, 1 faqe nga z. Sh. J; 14. Tërheqje parash nga “Western Union”, nr. \*\*\*, nga z. Sh. J, 1 fq; 14. Tërheqje parash nga “Western Union”, nr. \*\*\*, nga z. Sh. J, 1 fq; 15. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për fillimin e procedimit penal për vjedhje makine mbi bazën

2.17 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:**

2.18 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë në pronësi të personave të tjerë të lidhur/ babait dhe nënës, Sh. dhe D. J.

2.19 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin dhe të ardhurat e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesave të ndërtuara në vitin 1998

2.20 **Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, duke qenë se ai është shkëputur nga trangu familjar në vitin 2016, dhe vetëm bashkëbanon me prindërit, ata nuk janë persona të lidhur, referuar nenit 3, pika “13” të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arsyeton se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, Sh. dhe D. J, për efekt të ligjit nr. 84/2016 janë në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, për shkak se:**

i. Bashkëbanimi në një shtëpi gjatë vitit 2016 dhe pse një term i papërcaktuar nga ligji, si dhe fakti që subjekti i rivlerësimit deri në vitin 2016 ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit, përbën në vetvete lidhje interesi në dukje dhe që ka ekzistuar, që rrjedh nga interesi pasuror i përbashkët në shtëpinë ku kanë jetuar deri në 2016 dhe jetojnë aktualisht. Konfirmimi i marrëdhënies së bashkëbanimit nga ana e subjektit është posedim i sendit bazuar në ligj, pasi subjekti është fëmijë i ardhur nga martesja e z. Sh. dhe znj. D. J. Në këto kushte dhe të drejtat dhe detyrimet mbi të drejtat reale të qëndrimit në këtë banesë janë në kuadrin e të qenit bashkëpronar.

Neni 32, pika “4”, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.*

ii. Por dhe sikur mos ta konsiderojmë interes pasuror të parashikuar në nenin 32, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e djalit/fëmijës së babait dhe nënës së tij ka detyrimin moral dhe detyrimin juridik për të ndihmuar prindërit e tij me mjete monetare, në rastet kur ata janë të paafte për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Neni 192 të Kodit të Familjes, parashikon se: *“Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës: a) (...) fëmijët ndaj prindërve të tyre;”*

### 3. Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit

#### a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

3.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë.

3.3 Vërtetimet e pagave nga institucionet ku ka punuar subjekti i rivlerësimit.<sup>9</sup>

e kallëzimit të shtetasit Sh. J, 1 fq, 16. Mandatpagesë nga “FEFAD BANK”, nr. \*\*\*, datë 21.10.2002, në vlerë n prej 1.980 eurosh, 1 fq, 17. Mandatpagesë, nga “FEFAD BANK”, nr. \*\*\*, datë 25.10.2002, në vlerën prej 1.465 eurosh, 1 fq; 18. Mandatpagesë nga “FEFAD BANK”, nr. \*\*\*, datë 25.10.2002, në vlerë n 3.960 euro, 1 fq; 19. Lista e personave debitorë ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për dëme të shkaktuara në thyerje të ligjit, pa pasur siguracion për automjetin e tyre, Nr. rendor. 177 (fq. 5), i dëmtuar/përfitues Sh. J, shuma e përfituar 64.900 lekë, datë 04.10.2002, 26 fq, (<http://ëëë.insurers-al.org/pdf/lista%20e%20debitoreve.pdf>; <http://shekulli.com.al/38687/>); 20. Dëftesë postare drejtuar autoriteteve të ndryshme për kërkimin e provave, 3 fq. 21. Kërkesë drejtuar autoriteteve për marrje informacioni në lidhje me privatizimin e kamionit, 1 fq. 22. Fotografi e shtesës së katit, 6 fq; 23. Gjendja e të ardhurave të Sh. dhe D. J, prindërit e subjektit të rivlerësimit, 1 fq; 24. Këqyrja e apartamentit apartament banimi, me sipërfaqe 51 m2, krijuar nga privatizimi në vitin 1993, me nr pasurie \*\*\* ZK \*\*\*

<sup>9</sup> Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së :

Nxjerrje llogaritë nga “Raiffeisen Bank”, datë 18.01.2017, në emër të z. Gentian Jahjollit, mbi kreditimin e pagave. Gjendja në llogari, në datë 30.12.2016, në vlerën 461.448,23 lekë; Vërtetim page nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2016, i lëshuar nga Avokatura e Shtetit, për të ardhurat nga paga dhe shpërblimet për z. Gentian Jahjollin, për periudhën 2009 - 2011. Shuma 1. /02.844 lekë; Vërtetim page, nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për Gentian Jahjollin për periudhën 2011 - 2012. Shuma 698.717 lekë; Vërtetim page, nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për të ardhurat nga pagat për z. Gentian Jahjollin, për periudhën 2012 - 2014. Shuma 1.423 . 904 lekë.

**b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

**3.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë të ardhura nga puna si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë : (i) Në periudhën 1 mars 2014 deri në 31 dhjetor 2014, në vlerën 826.195 lekë; (ii) Në periudhën 1 mars 2015 deri në 31 dhjetor 2015, në vlerën 977.941 lekë; (iii) Në periudhën 1 janar 2016 deri në 31 dhjetor 2016, në vlerën 1 111 332 lekë Pra në total vlera prej **2.915.468 lekësh.****

**3.5** Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë shpërblim nga puna në Sekretariatit Teknik të Reformës për Drejtësi të depozituara në llogarinë rrjedhëse të pagave të punës, në vlerën prej 46.776 lekësh.

**3.6** Të ardhura nga mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin “Iliria”( jo publik). nga 3 orë në javë për periudhën shkurt - maj 2014, në vlerën 2.000 (dymijë lekë) për orë. 51 ore (pagese e pritshme) nga Universiteti “Iliria”, bashkelidhur VKM-ne e mbylles së këtij universiteti, nr. 539, datë 06.08.2014.

**3.7 Nga hetimi administrativ kryesisht, në dokumentacionin e administruar nga bankat dhe vërtetimet e pagave nga institucionet përkatëse, u konstatua se shuma e deklaruar nga subjekti përputhet me vlerat e pasqyruara në bankë si për nga burimi dhe nga shuma.**

**3.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.**

**4. Llogaria e kartës së kreditit pranë “Raiffeisen Bank”.**

**a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:**

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

4.2 Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e niveli të dytë.<sup>10</sup>

4.3 Shkresën e administruar nga “Raiffeisen Bank”.<sup>11</sup>

**b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

**4.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka një kartë krediti me limit kreditimi në vlerën 100.000 lekë të lidhur me llogarinë rrjedhëse të pagës, pranë “Raiffeisen Bank”.**

**4.5 Burimi i shlyerjes është nga paga e subjektit të rivlerësimit në të njëjtën bankë.**

**4.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, ishin në përputhje me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.**

**4.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.**

**5. Pasuritë dhe të ardhurat e personave të tjerë të lidhur/ nënës dhe babait të subjektit të rivlerësimit.**

<sup>9</sup>Kërkesë drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë, nr. \*\*\*, datë 26.06.2018.

<sup>10</sup>Kërkesë drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë, nr. \*\*\* datë 26.06.2018.

<sup>11</sup> Përgjigje nga “Raiffeisen Bank”, nr. \*\*\*, datë 29.06.2018.

5.1 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëbanon me prindërit dhe se deri në vitin 2016 kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare, referuar nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit/z. Sh. J dhe nëna e subjektit/znj. D. J, janë objekt i hetimit administrativ për efekt të ligjit nr. 84/2016

5.2 Në lidhje me deklarinimin që kanë bërë babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” për vitin 2017, Komisioni, arsyeton se ato nuk janë persona të lidhur dhe për këtë arsye nuk duhet të kishin deklaruar

5.3 Megjithatë, duke qenë se babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit konsiderohen persona të tjerë të lidhur për efekt të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, ka hetuar jo vetë deklarinimet e tyre në deklaratën “Vetting”, por ka shtrirë hetimin dhe më tej për të verifikuar nëse ato kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për të justifikuar marrëdhënien e interesit që kanë me subjektin e rivlerësimit.

## **1. Për apartamentin e banimit me sip. 51m<sup>2</sup> + 28.6 m<sup>2</sup> shtesë anësore dhe shtesë e katit sipër apartamentit me sip. 84.1 m<sup>2</sup>, në Tiranë.**

5.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, z. Sh. J dhe D. J kanë deklaruar se kanë në pronësi një apartament banimi me sip. 51m<sup>2</sup>, krijuar nga privatizimi në vitin 1991, nr. pasurie \*\*\*, ZK \*\*\*, shtesë anësore e apartamentit të banimit me legalizim (me sip. 28.6m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*, ZK \*\*\*) dhe shtesë e katit sipër apartamentit (me sip. 84.1m<sup>2</sup>) me nr. pasurie \*\*\*, ZK \*\*\*, ndërtuar që në vitin 1998, ndodhur në, Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, Njësia Administrative Nr. \*\*\*. Sipërfaqja 51+28,6+84,1m<sup>2</sup>.

5.5 Në lidhje me hetimin dhe përfundimin e Komisionit në lidhje me këtë aset në pronësi të prindërve, referohu pikës 2, më lart të këtij vendimi.

## **2. Automjet (autoveturë), tip “BMW 320”, prodhim i vitit 2001.**

### **a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:**

5.6 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

5.7 Dokumentacionin e administruar nga DPTRSH-së .

5.8 Dokumentacionin e administruar nga “ProCredit Bank”.

### **b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

5.9 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, z. Sh. J dhe D. J kanë deklaruar se kanë në pronësi një automjet (autoveturë), tip “BMW 320”, prodhim i vitit 2001, me nr. shasie \*\*\*, për përdorim personal. Blerë në Itali nga motra e z. Sh. J.

5.10 Burimi i krijimit nga kursimet ndër vite dhe ndihma e dhënë nga fëmijët.

5.11 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se ky automjet është sjellë nga halla e subjektit të rivlerësimit në Shqipëri (e cila ka paguar edhe detyrimet doganore). Halla e subjektit të rivlerësimit, znj. M. J, ka deklaruar, më datë 10.09.2012, se e ka shitur automjetin te z. Sh. J për vlerën 500 euro.

5.12 Nga analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit, rezultoi se personi tjetër i lidhur/babai i subjektit të rivlerësimit ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme financiare për të blerë këtë automjet në shumën 500 euro

5.13 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, si dhe analiza financiare, arrin në përfundimin se personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit/z. Sh. dhe znj. D. J kanë bërë deklarinim të

saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe kanë burime financiare të mjaftueshme me dokumentacion justifikues ligjor për të blerë këtë automjet.

### **3. Llogari depozite e përbashkët pranë “ProCredit Bank”.**

#### **a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:**

5.14 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

5.15 Dokumentacionin e administruar nga “ProCredit Bank”.<sup>12</sup>

#### **b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.**

5.16 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit, z. Sh. J dhe znj. D. J, kanë deklaruar se kanë një llogari depozite të përbashkët pranë “ProCredit Bank”, krijuar që nga viti 2005.

5.17 Burimi i krijimit të kësaj llogarie depozite janë të ardhurat nga puna e personit tjetër të lidhur/babait të subjektit ndër vite dhe nga dërgesat e motrës së personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit në emigracion në Itali.

5.18 Sipas deklaratimit të personave të tjerë të lidhur, vlera e kësaj llogarie depozite është në shumë 4.713 euro.

5.19 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se personat e tjerë të lidhur kanë pasur mundësi financiare nga të ardhura të ligjshme prej kësaj llogarie depozite pranë “ProCredit Bank”.

5.20 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, si dhe analiza financiare, arrin në përfundimin se personat e tjerë të lidhur me subjekti i rivlerësimit/z. Sh. dhe znj. D. J, kanë bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe kanë burime financiare të mjaftueshme me dokumentacion justifikues ligjor për të krijuar këtë depozitë.

#### **5.21 Si konkluzion për rivlerësimin e pasurisë:**

- i. Subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratë e pasurisë në kohë sipas ligjit nr. 84/2016;
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme; dhe
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS**

22. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

23. DSIK ja ka dërguar një raport të arsyetuar nr. \*\*\*, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, të KDZh-së, duke konkluduar mbi: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Sh. Jahjoll.”

24. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

25. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në

<sup>12</sup> Përgjigje nr. \*\*\*, datë 03.07.2018, nga “ProCredit Bank”.

mënyrë të pavarur të gjitha informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

26. Nga hetimi administrativ nuk rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

27. Si **konkluzion** për kontrollin e figurës rezultoi se:

- i. subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; dhe
- iii. subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

28. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Sh. Jaholli, i datëlindjes 11.10.1979, në mars 2014, ai ka filluar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht.

29. KLD-ja nuk disponon të dhëna arkivore për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, pasi ai asnjëherë nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë apo të dytë në Republikën e Shqipërisë.

### ANALIZA E GJETJEVE

30. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjorë të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore pranë KLD-së.

31. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, dokumentet ligjorë të paraqitura nga subjekti dhe ato të përzgjedhura me short e të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I dhe II të këtij raporti, me termat "*dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3, dokumenti 4, dokumenti 5, dokumenti 6, dokumenti 7 dhe dokumenti 8*".

#### Aftësitë profesionale

32. **Njohuritë ligjore** - Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, ka aftësi të mjaftueshme në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara, duke mbajtur në konsideratë edhe mungesën e përvojës së mëparshme gjyqësore të subjektit, konfirmojnë njohuritë e tij në të drejtën penale, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ai ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit - ndihmës ligjor në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, i ardhur nga jashtë sistemit gjyqësor, në mars të vitit 2014.

33. Të të dokumentet ligjore konfirmojnë njohuritë e tij ligjore në fushën e të drejtës penale dhe të drejtës procedurale penale, që lidhen qoftë me lloje të ndryshme të veprave penale, qoftë me rregullat e përgjithshme materiale penale apo qoftë edhe me çështje të ndryshme procedurale. Njohuritë e tij ligjore rezultojnë edhe nga formimi i tij të plotë akademik, ku pas përfundimit të studimeve universitare, ai ka kryer studimet dhe ka marrë titujt "Master" dhe "Doktor", pikërisht në fushën e të drejtës penale, për më tepër që këto studime i ka kryer në Itali.

**34. Arsyetimi ligjor – Tre dokumentet ligjorë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë të shkruara qartë në mënyrë të kuptueshme dhe të strukturuar. Edhe në pesë relacionet e vëzhguara të përzgjedhura me short, është ruajtur një strukturë e qartë arsyetimi. Në të tre rastet mendimi i ndihmësit ligjor nëse rekursi duhet pranuar apo jo është evaziv, duke e lënë në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (shih dokumentet 6, 7 dhe 8), ndërsa në një rast ku çështja është pushur për shkak të tërheqjes së rekursit nga palët, propozimi i ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes mungon në relacionin e tij (shih dokumentin 5). Nga pesë dokumentet e përzgjedhura me short, në katër raste mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës (shih dokumentet nr 4, 6, 7 dhe 8). Në këto pesë dokumente të vëzhguara, është konstatuar se analiza ligjore mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit është paraqitur në mënyrë të përmbledhur me 1 - 3 paragrafë, por në thelb analiza e tij përputhet me vendimmarrjen e gjykatës (shih dokumentet 4, 6, 7 dhe 8).**

**35. Në tre dokumentet ligjorë është konstatuar se është pasqyruar mendimi i ndihmësit ligjor për zgjidhjen konkrete të çështjes (shih dokumentet 1, 2, dhe 3), ndërsa pesë dokumentet e përzgjedhura me short janë formalë: ato përmbajnë strukturën e detyrueshme ligjore, por në përmbajtje nuk kanë argumente të thelluara ligjore mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit edhe pasqyrimi i relacioneve të asytlimit të vendimeve të përdorura nga gjykatat e faktit, është paraqitur me ato argumente përdorura nga gjykatat përkatëse si dhe qëndrimet e tyre lidhur me pretendimet kryesore të palëve. Në asnjë dokument nuk evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë të së drejtës, analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuara. Vlen të evidentohet se tetë dokumente ligjore të paraqitura prej tij janë brenda periudhës së rivlerësimit.**

**36. Nga pikëpamja formale çdo relacion përmban elementët e parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë. Secili prej tyre pasqyron rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs. Në drejtim të shkrimit ligjor, paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Megjithatë, në të gjitha rastet është konstatuar se relacioni është pa datë dhe pa nënshkrimin e ndihmësit ligjor.**

#### **Aftësitë organizative**

**37. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë - Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, në periudhën e rivlerësimit mars 2014 - tetor 2016, ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, i ardhur nga jashtë sistemit gjyqësor. Rredhimisht, aftësitë e tij vlerësohen për më pak se 3 vjet punë. Në nenin 41, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet: “*Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për afekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.*”**

**38. Lidhur me ngarkesën sasiore, ai ka deklaruar se në funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2014, ka relatuar 337 çështje, në vitin 2015 ka relatuar 334 çështje dhe në vitin 2016 ka relatuar 175 çështje. Këto të dhëna nuk dokumentohen me shkresë nga Gjykata e Lartë. Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën edhe pesë dokumentet ligjorë, rezulton të ketë relatuar 779 çështjeve me natyrë penale, por nga këto vetëm 391 kanë kopjen e relatimit të ndihmësit ligjor, z. Gentian Jahjollli, ndërsa 388 dosje nuk kanë aktin e relatimit ose akti është pa emër. Për rrjedhim, shortit iu nënshtruan vetëm 391 çështje si ngarkesë pune në aspektin sasior.**

**39. Në analizën e këtyre të dhënave duhen evidentuar tre faktorë: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrin e çështjeve për relativitet që i janë caktuar dhe rrjedhimisht, rendimenti i**

punës së tij nuk mund të përcaktohet; (ii) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (iii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativitet dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësi ligjor, bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësës ligjore të përzgjedhur me short për vlerësim.

**40. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore** - Nga të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e tetë dokumenteve ligjore konstatohet se ndihmësi ligjor ka studiuar çështjen gjyqësore që ka relatuar në çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, analizën ligjore, si dhe shkaqet e rekursit apo kundërrekursit. Këto veprime ai i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar (edhe pse në disa raste formalisht) elementët proceduralë të kërkuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014, të kryetarit të kësaj gjykate.

**41. Aftësia për të administruar dosjet** - Nga pesë dokumentet e përzgjedhur me short, në pesë raste rezultoi se mendimi i ndihmësit ligjor është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse. Nga ana tjetër, duhet theksuar se asnjë prej dokumenteve të paraqitura dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

#### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

**42. Etika në punë** - Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, është specializuar, Doktorant, në “Universitetin Sapienza di Roma”, Master Legum Magistër, (LLM) në International Organisation, International Criminal Law and Crime Prevention dhe Dottore Magistrale in Giurisprudenza, Jurist. Në periudhën mars 2014 e aktualisht, ai ushtron detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë për shkak se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, nuk ka qenë subjekt i Inspektoratit të KLD-së. Po ashtu, për të nuk ka akt vlerësimi nga gjyqtari dhe kryetari i Gjykatës së Lartë për këtë aspekt.

**43. Integriteti** - Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, dhe nga pesë dokumentet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**44. Paanësia** - Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë relacionet e vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

#### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

**45. Aftësitë e komunikimit** - Në të tetë dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, me palët ndërgjyqëse pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta. Ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë, i plotë dhe i saktë.



**46. Aftësia për të bashkëpunuar** - Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë konstatuar vonesa në relativimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

**47. Gatishmëria për t'u angazhuar** - Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas përfundimit të studimeve universitare, ai është specializuar Doktorant, në Universitetin Sapienza di Roma, Master Legum Magistër, (LLM) në International Organisation, International Criminal Law and Crime Prevention dhe Dottore Magistrale in Giurisprudenza, Jurist. Nga marsi 2014 e në vijim, ai ushtron detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, ka marrë pjesë në tre aktivitete profesionale trajnuese, 1 brenda programit të Shkollës së Magistraturës dhe 2 jashtë këtij programi, gjithsej 5 ditë (*shih trajnimet në 3 vitet e fundit*). Ai ka deklaruar edhe një listë të gjatë angazhimesh në aktivitete profesionale ndër vite, për të cilat mund të konsultohet lista e inventarit, 1- 45 numrin rendor. Në përmbledhje të këtyre të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, është shfaqur vijimisht i gatshëm për t'u angazhuar në aktivitete profesionale me qëllim rritjen e aftësive teknike.

**48. Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale** - Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në një analizë të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**49.** Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli: "i aftë".

**50.** Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa "c", të ligjit nr. 84/2016.

## VIII. KONKLuzioni Përfundimtar

**51.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Jahjollli, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës "c", të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit nderkombëtar, z. John Leonardo, dhe referuar nenit 58, pika 1, germa "a", si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr.

84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Jahjoli, këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

*Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 09.01.2019.*

#### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Firdes SHULI**  
Kryesuese

**Pamela QIRKO**  
Anëtare

**Etdeda ÇIFTJA**  
Relatore

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*